



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Misioni i Pajtimit Mbarekombetar
“NENE TEREZA“

Adresa: Shtepia e Ushtarakeve, Kati 3, Shkoder- ALBANIA

Tel. +355692633015

Nr.173/11. Prot

Shkoder, me 16/10/2011

VERTETIM

Me ane te te cilit vertetojme se z. Elvis NABOLLI, i datelindjes 11 shtator 1986, lindur e banues ne Shkoder, eshte rregjistruar prane Misionit sone si person i rrezikuar nga fenomeni i gjakmarrjes.

Xhaxhai i Elvisit, Faiku eshte kthyer per pushime nga Greqia ku eshte emigrant prej vitesh. Teksa udhetonte me makinen e tij, nje makine tjetere e drejtuar nga Marash Zefi, banor i fshatit Bardhaj por me origjine nga Dukagjini, e ka goditur me makine. Pasi eshte ulur nga makina, Faiku i ka kerkuar Marashit qe te marre persiper riparimin e demeve meqenese ishte ai fajtor. Marash Zefi, jo vetem nuk ia ka marre persiper kthimin e makines ne gjendje para perplasjes, por i ka lene celesta e makines se tij ne dore Faikut, duke i thene se me ke 5.000.000 leke borxh sepse aq me ka kushtuar makina. Me kot Faiku eshte munduar ta binde dhe madje Marashi e ka goditur me grusht. Pas sekonda me pas, pasi eshte ngritur nga toka, ka shkuar ne makinen e tij, ka marre nje pistolete qe e mbante pa leje dhe ka qelluar te drejtim te Marash Zefit. Edhe pse ka marre plage ne trup, Marashi me nderhyrjen e mjekëve ka shpetuar, por kane filluar problemet per nipin e Faikut, Elvis Nabollin. Familja Zefi ka deklaruar se ne baze te Kanunit, gjaku lahet me gjak dhe meqe Faiku eshte rikthyer ne Greqi, ne do ta marrim hakun tek nipi i tij. Sipas Kanunit, fisi i demtuar ka te drejte te vrases me te njohurin, me te mirin e fisit Nabolli dhe ky eshte pikerisht Elvisi, i cili punon gazetar dhe eshte i rrezikuar cdo dite me jeten.

Misioni yne ka bere te gjitha perpjekjet per ta mbyllur kete histori gjakmarrjeje, por nuk ia ka arritur te realizoje pajtimin ne mes dy fiseve, te cilat tashme jane ne hasmeri. Gazetari Elvis Nabolli perfshihet tashme ne listen e gjate te viktimave te gjakmarrjes, duke qene i kercenuar me jete edhe gjate ushtrimit te profesionit te tij.

Per Misionin e Pajtimit Mbarekombetar
“NENE TEREZA“

Kryetari

Gjin MEKSHI

